



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 47

2001

Tetor

### P Ë R M B A J T J A

|                                |   | Faqe |
|--------------------------------|---|------|
| Ligj nr.8814<br>datë 20.9.2001 | Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 3.9.2001 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”.   | 1475 |
| Ligj nr.8815<br>datë 20.9.2001 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane, lidhur me veprimtarinë e bashkëpunimit dhe asistencës për ristrukturimin e infrastrukturave logjistike dhe stërvitore në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe për risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pishë - Poro”... | 1475 |
| Ligj nr.8816<br>datë 20.9.2001 | Për ratifikimin e “Protokollit të tretë shtesë të “Marrëveshjes së Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore”   | 1483 |
| Ligj nr.8817<br>datë 27.9.2001 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit Tregtar dhe Ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit” .....  | 1486 |

|  |  |      |
|--|--|------|
| Ligj nr. 8818,<br>datë 27.9.2001           | Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për krijimin e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë ligjore”..  | 1492 |
| Dekret nr.3116<br>datë 9.10.2001           | Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme në zonën zgjedhore nr.98, Delvinë .....   | 1502 |
| Dekret nr.3117<br>datë 10.10.2001          | Për dhënie dhe lënie të shtetësisë shqiptare .....   | 1503 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.7, datë 15.10.2001 | Shqipëria – Pjesëtare e Aleancës së Gjerë kundër Terrorizmit Ndërkombëtar .....  | 1504 |
| Vendim i KM<br>nr.566, datë 13.10.2001     | Për një shtesë fondi në Buxhetin e Vitit 2001, miratuar për Gjykatën Kushtetuese .....   | 1505 |
| Vendim i GJK<br>nr. 117, datë 28.8.2001    | Me objekt shfuqizimin e pjesshëm të vendimeve nr. 227 dhe nr. 228, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si të papajtueshëm me nenin 64/2 të Kushtetutës.....   | 1506 |
| Vendim i GJK<br>nr.124, datë 27.9.2001     | Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.33, datë 7.6.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr.126 datë 26.9.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.153, datë 8.2.2001 të Kolegjit Penal Gjykatës së Lartë..... | 1508 |

**L I G J**  
**Nr.8814, datë 20.9.2001**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.6, DATË 3.9.2001  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8718, DATË  
19.12.2000 “PËR BUXHETIN E SHETIT TË VITIT 2001” ”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave, nr.6, datë 3.9.2001 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001””.

**L I G J**  
**Nr. 8815, datë 20.9.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS  
ITALIANE, LIDHUR ME VEPRIMTARINË E BASHKËPUNIMIT DHE TË ASISTENCËS  
PËR RISTRUKTURIMIN E INFRASTRUKTURAVE LOGJISTIKE DHE STËRVITORE NË  
AKADEMINË E FORCAVE AJRORE NË VLORË DHE PËR RISISTEMIMIN E PISTËS SË  
FLUTURIMIT PREJ DHEU NË PISHË - PORO”**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane, lidhur me aktivitetin e bashkëpunimit dhe asistencës për rristrukturimin e infrastrukturave logjistike dhe stërvitore në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe për risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pish Poro”, nënshkruar në Tiranë, më datë 7 qershor 2001.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3092, datë 22.9.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

## MARRËVESHJE

### MIDIS MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS ITALIANE, LIDHUR ME VEPRIMTARINË E BASHKËPUNIMIT DHE TË ASISTENCËS PËR RISTRUKTURIMIN E INFRASTRUKTURAVE LOGJISTIKE DHE STËRVITORE NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE NË VLORË DHE PËR RISISTEMIMIN E PISTËS SË FLUTURIMIT PREJ DHEU NË PISHË-PORO

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës Italiane, të quajtura në vazhdim "Palë",

Në bazë: të Marrëveshjes së NATO (SOFA) Pfp ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995;

Në bazë: të Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës Italiane dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi Bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes, firmosur në Romë në datë 13 tetor 1995, ratifikuar nga Parlamenti Italian me ligjin nr.49 datë 18 shkurt 1999 dhe nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.8128 datë 22 korrik 1996.

Në bazë: të dekretit ligj nr.1 të 13 janarit 1998, të Parlamentit Italian, koordinuar me ligjin nr.42, datë 13 mars 1998, "Dispozitat urgjente në fushën e bashkëpunimit midis Italisë dhe Shqipërisë në sektorin e mbrojtjes, si dhe zgjatja e qëndrimit të kontigjentëve ushtarakë italianë në Bosnjë-Hercegovinë. Zgjatja e pjesëmarrjes së vëzhguesve italianë në grupin e vëzhguesve të përkohshëm në Hebron";

Në bazë: të Protokollit Teknik midis Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës Italiane, "Mbi përmbushjen e Marrëveshjes Ndërqeveritare për bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes, firmosur në Romë më 28 gusht 1997;

DUKE PATUR PARASYSH: faktin, që Pala shqiptare ka kërkuar rristrukturimin e infrastrukturave logjistike dhe stërvitore të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë dhe risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pishë- Poro;

DUKE KONSIDERUAR: "Deklaratën Paraprake", nënshkruar në Tiranë, më 15 qershor 2000, nga Ministrat e Mbrojtjes të të dy vendeve;

Kanë rënë dakord për sa vijon:

#### Neni 1

1.Kjo Marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e detyrimeve reciproke që Palët marrin përsipër për vënien në zbatim të projekteve për rristrukturimin dhe përmirësimin e kapaciteteve logjistike të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë nëpërmjet ndërhyrjeve me qëllimri kuperimin dhe riaftësimin e infrastrukturave dhe të pistës së fluturimit prej dheu të zonës aeroportuale të Pishë - Poros, të cilën Pala Shqiptare ka parashikuar për ta rivënë në përdorim për aktivitetin stërvitor të fluturimit.

2. Palët do të veprojnë së bashku, duke respektuar rregullat e brendshme juridike përkatëse dhe duke përdorur çdo formë të dobishme bashkëpunimi për një përdorim optimal të burimeve të disponueshme në kuadër të ndërhyrjeve të përcaktuara në nenin 2 e në vazhdim.

#### Neni 2

1. Aktiviteti i bashkëpunimit dhe asistencës midis Palëve, nëse nuk përcaktohet ndryshe nga kjo Marrëveshje, do të zhvillohet siç është përcaktuar në Protokollin e 28 gushtit 1997.

2. Pala italiane do të japë konsulencë dhe asistencë teknike si në fazën projektuese, ashtu dhe në fazën ekzekutive të punimeve, do të sigurojë furnizimin me materiale të nevojshme për kryerjen e punimeve të parashikuara dhe të përshkruara në Shtojcat "A" dhe "B" të kësaj Marrëveshjeje. Përsa i përket procedurave kontraktuale për furnizimin me materiale do të aplikohen normat e Bashkimit Europian.

3. Pala italiane do të përjashtohet nga taksat dhe detyrimet doganore që aplikohen në Shqipëri për personelin dhe materialet që do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas

Marrëveshjes NATO (SOFA) / Pfp, të nevojshme për kryerjen e punimeve që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje dhe që do të transportohen nga Italia për në Shqipëri.

4. Pala italiane, për kryerjen e detyrave të caktuara sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për sigurimin dhe ruajtjen brenda zonës së punimeve, të personelit, të infrastrukturave, të materialeve dhe të mjeteve të punës është e autorizuar të dërgojë dhe të vendosë në Shqipëri, në zonën e Vlorës, një njësi logjistike të Aviacionit Ushtarak Italian me elemente riparimi, mirëmbajtjeje, ruajtjeje dhe sigurimi me një personel jo më shumë se 200 trupa. Përbërja dhe detyrat e kësaj njësie logjistike janë përcaktuar në shtojcat "A", "B" dhe "C", bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje. Njësia logjistike e Aviacionit Ushtarak Italian do të jetë e pranishme në Shqipëri derisa të përfundojnë punimet sipas shtojcave "A" dhe "B",

5. Veprimtaria e njësisë logjistike në Shqipëri, do të kryhet në përputhje të plotë me dispozitat e Marrëveshjes NATO (SOFA) / Pfp dhe Protokollit të saj, shtesë.

6. Pala shqiptare do të impenjohet të përgatisë projektin e punimeve dhe për ekzekutimin e tij do të caktojë Drejtorin e Punimeve, përgjegjës për zbatimin me korrektësi të punimeve dhe të rregullave të sigurisë në kantieret, duke u mbështetur në asistencën dhe konsulencën teknike të palës italiane, si dhe do të sigurojë krahun e punës, mjetet dhe mbështetjen logjistike të nevojshme.

7. Për kryerjen e punimeve, e cila është qëllimi i kësaj Marrëveshjeje, Pala shqiptare është përgjegjëse për projektin, zbatimin dhe kolaudimin e strukturave, si dhe për përdorimin korrekt të materialeve të dhëna nga Pala italiane.

Në këtë kontekst Pala shqiptare do të jetë përgjegjëse ndaj Palëve të treta përsa i përket zgjidhjes së ndonjë pretendimi për pronësinë dhe dëmeve materiale të shkaktuara ndaj të tretëve gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 3

Pala shqiptare, në veçanti, do të impenjohet:

a) në caktimin e projektuesit, drejtorit të punimeve dhe përgjegjësve të skuadrave që janë të aftë dhe të specializuar në këto punime;

b) të bëjë të mundshëm përdorimin e mjeteve të kantierit dhe mjeteve të transportit që ka në dispozicion, mes të cilave dhe ato që ka dhënë pala italiane, duke përfshirë drejtuesit e automjeteve dhe pjesët e këmbimit;

c) të sigurojë numrin e nevojshëm të krahut të punës, për të kryer në rregull punimet, e që do të veprojnë nën vartësi të drejtpërdrejtë dhe nën përgjegjësinë e drejtorit të punimeve;

d) të krkojë nga autoritetet kompetente autorizimet e parashikuara për të gjitha punimet që do të kryhen (lidhjet elektrike me tensione të mesëm, hidrike, kanalizimet etj).

2. Pala italiane, në veçanti, impenjohet:

a) në caktimin e konsulentëve që do të punojnë në krah të projektuesit, drejtorit të punimeve dhe përgjegjësve të skuadrave të Palës shqiptare;

të japë asistencë teknike për të gjithë mjetet që do të përdoren gjatë punimeve;

të furnizojë me materialet e ndërtimit të nevojshëm për kryerjen e punimeve.

d) të ndihmojë, me aq sa mundet, me personel të specializuar që nevojitet për kryerjen e punimeve për ristrukturimin e Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë.

3. Në shtojcën "D" të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet organizimi i grupeve të punës në përgjithësi.

Për shtesa të vogla të mundshme që mund të nevojiten në sektorët e parashikuar të punimeve, do të bihet dakord nga të dy palët, duke përcaktuar herë pas here nevojat dhe disponibilitetin.

### Neni 4

1. Pala shqiptare do të sigurojë:

a) hyrjen e mjeteve ushtarake italiane të transportit tokësor dhe ajror, si dhe përdorimin e infrastrukturave dhe të zonave të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë si dhe të pistës së fluturimit

prej dheu në Pishë - Poro, për qëllimet e përcaktuara në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje;

b) vënien në dispozicion të vendeve ku do të vendoset zona e kantierit;

c) ndihmën logjistike të plotë për personelin e vet dhe për automjetet e veta në përdorim, për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të asaj që parashikohet.

d) zona dhe struktura të përshtatshme në të cilat do të vendosen, magazinohen dhe ruhen të gjitha materialet, mjetet dhe veglat që do të përdoren gjatë punimeve;

e) me ndihmën e Policisë Ushtarake, sigurinë e vazhdueshme në zonat e kantierit të personelit, të infrastrukturave, të materialeve dhe të mjeteve që do të përdoren gjatë punimeve për të cilën bën fjalë kjo Marrëveshje.

2. Pala italiane do të sigurojë:

a) mbështetjen e plotë logjistike për personelin e vet;

b) ushqim për personelin e të dy palëve të punësuar në zonat e kantierëve;

c) karburantet dhe lubrifikantet për të gjitha mjetet e kantierit të përdorura nga Pala shqiptare;

d) ndihmën në mirëmbajtje dhe riparimin e mjeteve duke u kufizuar në ato të dhëna nga pala italiane me përjashtim të pjesëve të këmbimit.

#### Neni 5

Secila prej Palëve impenjohet, që të japë ndihmë shëndetësore të ndihmës së shpejtë të gjithë personelit të punësuar në punime. Në rast se nevojitet transport shëndetësor në spital i të lënduarve, të dyja palët do të vënë në dispozicion një autoambulancë të pajisur me të gjitha mjetet, e cila duhet të jetë vazhdimisht e pranishme në kantier për çdo urgjencë.

#### Neni 6

1. Mbi bazën e aktiviteteve të parashikuara në Projektin e Ristrukturimit të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë, Palët mund të bien dakord për gjetjen e formave të tjera të bashkëpunimit në sektorin e stërvitjes së aviacionit. Në këtë kuadër, Palët mund të bien dakord për nisma lidhur me nisjen e programeve në shkëmbimin e personelit, si dhe për dërgimin e ekspertëve ushtarakë italianë në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë me qëllim dhënien e konsulencës për aktivitetin e fluturimit dhe të mësuarit e lëndëve teknike të trajtuara, në bazë të protokollit të datës 28 gusht 1997.

2. Palët impenjohen, gjithashtu që të zhvillojnë së bashku dhe në bazë të kësaj Marrëveshjeje, një projekt për shndërrim në strukturë aeroportuale të pistës së fluturimit prej dheu në Pishë - Poro.

#### Neni 7

1. Personeli italian në Shqipëri do të gëzojë statusin juridik, që parashikohet nga Marrëveshja NATO (SOFA) PfP dhe nga Protokollin i saj shtesë. Kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen mutatus mutandis, për të gjitha situatat që lidhen me statusin juridik të personelit të njësisë logjistike të Aviacionit Ushtarak Italian.

2. Gjatë qëndrimit në Shqipëri, ushtarakët italianë të njësisë logjistike të Aviacionit Ushtarak, për ruajtjen dhe sigurimin e personelit si dhe të furnizimeve materialo-teknike, në zonat e kantierit (Akademia e Forcave Ajrore dhe pista e fluturimit prej dheu në Pish-Poro), gjatë shoqërimit të mjeteve dhe të kolonave italiane në linjat e komunikimit në interes të këtyre punimeve dhe në vendakomodimet e tyre, do të veprojnë në përputhje me ligjin 8290 të datës 24 shkurt 1998 të Parlamentit Shqiptar "Për përdorimin e armëve të zjarrit", për aq sa pajtohet me sistemin juridik italian.

## Neni 8

1. Punimet që lidhen me ristrukturimin e Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë dhe të pistës së fluturimit prej dheu në Pishë-Poro, do të përcaktohen formalisht me Marrëveshje të detajuara, të formuluar dhe pranuar me mirëkuptim midis ekspertëve të të dy Palëve.

2. Kohëzgjatja e nevojshme për kryerjen e punimeve të parashikuara dhe vlefshmëria e kësaj marrëveshjeje është 6 (gjashtë) muaj, duke filluar nga data e firmosjes, me të drejtë përsëritjeje automatikisht, me pëlqimin e Palëve, edhe për një periudhë tjetër 6 (gjashtë) mujorë, në rastet kur për shkaqe të arsyeshme nuk kanë përfunduar ende punimet.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet, modifikohet ose amendohet, në çdo moment, me pëlqimin paraprak me shkrim të të dy Palëve.

4. Kjo Marrëveshje mund të ndërpritet në çdo moment nga njera ose të dy Palët duke njoftuar me shkrim 30 ditë përpara.

5. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga një interpretim i ndryshëm i neneve të kësaj Marrëveshjeje për zbatimin e saj të mëpastajshëm, do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve mes të dy palëve, pa iu drejtuar një Pale të tretë.

6. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi përkohësisht në momentin kur të dyja Palët do të kenë firmosur dhe përfundimisht, kur palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të miratimit.

Përfaqësuesit e nënshkruar, me autorizimin e duhur, për palën italiane dhe për palën shqiptare kanë firmosur përkatësisht këtë Marrëveshje në Tiranë, më 4.6.2001 dhe në Romë, më 7.5.2001, në dy origjinale, në gjuhën shqipe dhe italiane, ku secili tekst është i barazvlefshëm me njëri-tjetrin.

### SHTOJCA "A"

#### NDËRHYRJET E PROGRAMUARA PËR ZONËN LOGJISTIKE TË AKADEMISË SË FORCAVE AJRORE

1. Punimet kanë për qëllim ristrukturimin e ndërtesave të treguara në planimetrinë Aneksi 1, të shënuara me numrat nga 1, 3, 4, 5, 6, 7.

2. Punimet do të tregohen të detajuara në projektin final të përpunuar nga pala shqiptare bashkë me palën italiane. Në veçanti bëhet fjalë për:

- kryerjen e punimeve për ringritjen e mbulesës, aty ku është e nevojshme, zëvendësimin dhe/ose ristrukturimin e ullukeve;

- realizimin e grupeve të banjove dhe dusheve, aty ku është e nevojshme të pajisur me të gjithë impiantin e nevojshëm hidrik me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë dhe sharkimin e ujrave të zeza deri në pusetën jashtë ndërtesës;

- riparimin, ku është i nevojshëm, të mureve, çatave, suvatimeve, dysHEMEVE, lyerjes me bojë jashtë dhe brenda;

- realizimi i impiantit elektrik sipas kushteve teknike, me plato ndriçimi prej neoni.

3. Infrastruktura e paraqitur me nr.8 i referohet një parafabrikati betoni, i cili do të ketë në përbërje komponentët tashmë të projektuar dhe të montuar nga një ndërmarrje për një central elektrik MT/BT-6000 V/380 - me fuqi rreth 300 KVA, që do të ushqehet nga një kavo elektrike nëntokësore nga shtylla MT më e afërt.

4. Secila nga ndërtesat duhet të jetë e kompletuar me:

- energji elektrike, të instaluar në tuba me kavo, që vjen nga centrali ndërtesa nr.8 deri tek kuadrot e vendosur në hyrjen e çdo ndërtese;


- realizimin e rrjetit hidrik dhe të depos së ujit me sistem autoklavë me anë të lidhjes me rrjetin hidrik të qytetit që është brenda Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë;

- kanalizimet e ujërave të zeza deri tek kanalizimet e qytetit nëpërmjet tubacionit në PVC të rëndë dhe pusetat e nevojshme shpërndarëse dhe të kontrolleve.

5. Gardhi metalik mbi perimetrin e treguar nga pala shqiptare do të realizohet sipas standardit italian.

Aneksi i Shtojcës “A”

**PLANIMETRI E ZONËS LOGJISTIKE**  
(Gastbë shkallës)





**SHTOJCA "B"**  
**NDËRHYRJET E PROGRAMUARA NË ZONËN OPERATIVE TË PISHË-PORO-S**

1. Ndërtimi i një gardhi rrethues përgjatë perimetrit të zonës në fjalë, nivelimi paraprak i terrenit me mjetet mekanike dhe pastrimi i kanalit kullues.

Parashikohet realizimi i një mbikalimi në kanal in kullues dhe i një porte me kangjella metalike, në korrespondencë me hyrjen e bazës në veri dhe me hyrjen në lindje të zonës aeroportuale.

2. Përgatitja e rrugës perimetore, nëpërmjet nivelimit dhe ngjeshjes. Sjellja e materialeve për shtresën fundore të rrugës, në pjesën e rrugës perimetore, që nga hyrja lindet me hyrjen në veri dhe me vendkomandën e kullën e kontrollit.

3. Vendosja e karër parafabrikeve për banim dhe një parafabriki për nevoja higjenike, të cilat do të përbëjnë godinat për personelin e rojës, katër parafabrikeve për banim dhe një parafabriki për nevoja higjenike për komandën, si dhe dy parafabrikeve për banim sipër njëra - tjetrës për kullën e kontrollit. Të gjitha këto parafabrike duhet të jenë të pajisura dhe të furnizuara me energji elektrike, ujë dhe shkarkimet e ujrave të zeza.

4. Përgatitja, nëpërmjet nivelimit dhe ngjeshjes së pistës së fluturimit prej dheut të parashikuar për nevojat lidhur me fluturimin e mjeteve fluturuese stërvitore.

5. Vendosja e një gypi ajrimi aeroportual dhe mjeteve të shërbimit sinoptik në afërsi të kullës së kontrollit.

**SHTOJCA "C"**  
**PËRBËRJA DHE DETYRAT E NJËSISË LOGJISTIKE TË AVIACIONIT USHTARAK ITALIAN**

1. Njësia Logjistike e Aviacionit Ushtarak Italian përbëhet nga:

- Një komponent komande e përbërë nga minimumi 22 veta deri në maksimumi 25 veta, me detyra komande dhe bashkërendimi;

- një komponent asistence teknike për projektimin, kryerjen dhe kolaudimin e punimeve e përbërë nga minimumi 21 veta deri në maksimumi 46 veta me detyrë dhënien e ndihmës së specializuar dhe asistencës teknike Palës shqiptare;

- një komponent për mbështetje logjistike e përbërë nga minimumi 57 veta deri në maksimumi 78 veta me detyrë dhëniej e mbështetjes logjistike njësisë dhe mbështetjen për kryerjen e punimeve të ristrukturimit të infrastrukturave në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë, si dhe të pistës së fluturimit prej dheu në Pishë-Poro;

- një komponent ruajtje dhe sigurimi i përbërë nga minimumi 48 veta deri në maksimumi 51 veta për sigurinë e personelit italian dhe ruajtjen e mjeteve dhe materialeve.

2. Përbërësit e njësisë logjistike janë të autorizuar të veshin uniformën italiane dhe gjatë kryerjes së shërbimit të tyre të mbajnë armatim individual, siç është paraqitur nga Marrëveshja NATO (SOFA) Pfp.

**SHTOJCË "D"**  
**GRUPET E PARASHIKUARA TË PUNËS**

1. Për kryerjen e punimeve të parashikuara konsiderohet e domosdoshme ngritja e nr.3 grupe pune, aktivizimi i të cilave do të nisë sipas nevojës në momentin e duhur të zhvillimit të punimeve, siç tregohet më poshtë:

a) grupi i punës në Pishë-Poro;

b) grupi i punës në Akademinë e Forcave Ajrore për ristrukturimin e brendshëm të ndërtesave;

c) grupi i punës në Akademinë e Forcave Ajrore për punimet nga jashtë ndërtesave.

2. Çdo grup duhet të ketë në përbërje praninë konstante të dy asistentëve ekspertë për punimet në kryerje e sipër, njëri italian dhe tjetri shqiptar.

3. Numri i grupeve mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve gjatë kryerjes së punimeve.

**L I G J**  
**Nr.8816, datë 20.9.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË TRETË SHITESË  
TË “MARRËVESHJES SË FORCËS SHUMËKOMBËSHE PAQERUAJTËSE TË EUROPËS  
JUGLINDORE””**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i tretë shtesë i “Marrëveshjes së Forcës Shumëkombëshe paqeruajtëse të Europës Juglindore””, nënshkruar në Athinë, më datë 21 qershor 2000.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3093, datë 22.9.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**PROTOKOLLI  
I TRETË SHITESË I MARRËVESHJES SË FORCËS SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS  
JUGLINDORE**

Shtetet Palë në Marrëveshjes e Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore, nënshkruar në Shkup më 26 shtator 1998;

Duke marrë në konsideratë se, në përputhje me Marrëveshjen e Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Evropës Juglindore, dispozitat e Pfp SOFA dhe protokoll shtesë i saj, në parim, duhet të jenë të aplikueshme sipas ndryshimeve të nevojshme të Marrëveshjes.

Me dëshirën për të përcaktuar satusin e përshtatshëm të Shtabit të SEEBRIG, të vendosur përkohësisht ose mbi bazën e rotacionit, në territoret e tyre, në përputhje me Marrëveshjen e Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore dhe personelit të tij e familjeve të tyre, bien dakort si më poshtë:

Neni 1

Në këtë Protokoll shprehjet:

a) “Marrëveshja e PPFSEE-së do të thotë Marrëveshja e Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Europës Juglindore, nënshkruar në Shkup më 26 shtator 1998.

b) “Pfp SOFA” do të thotë Marrëveshja midis Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel më 19 qershor 1995.

c) “Shtabi i SEEBRIG”-ut do të thotë Shtabi i Forcës, siç përcaktohet në Nenin 7 të Marrëveshjes së MPFSEE-së dhe Aneksit C të saj.

d) “Personel” do të thotë personeli ushtarak dhe civil i Shtabit SEEBRIG-ut.

e) “Pjesëtarët e familjes” do të thotë bashkëshortja ose fëmijët e anëtarëve të shtabit.

## Neni 2

Deri sa nuk shpallet ndryshe në Marrëveshjen e PPFSEE, Aneksat dhe dispozitat, kushtet e këtij Protokollit, kushtet e Pfp SOFA dhe protokollat shtesë të saj do të zbatohen brenda territorit të vendit pritës ose të çdo shteti tjetër nënkruar të Marrëveshjes së MPFSEE në të cilin është vendosur Shtabi. Të drejtat dhe detyrimet në lidhje me kodin penal dhe disiplinor si dhe pretendimet do të ushtrohen nga shtetet dërguese, në përputhje me dispozitat përkatëse të Pfp SOFA.

## Neni 3

Personeli dhe anëtarët e familjeve të tyre do të mbajnë kartën e identitetit personal, e cila do të lëshohet nga autoritetet përkatëse të vendit pritës, ku do të tregohet emri, data dhe vendi i lindjes, kombësia, rangu ose grada, numri, fotografia dhe afati i përdorimit. Kjo kartë do të tregohet sipas kërkesës dhe nga pikëpamja administrative do të vërtetojë se mbajtësi i saj është anëtar i personelit ose familjeve të tyre.

## Neni 4

Personeli dhe anëtarët e familjeve të tyre do të përfitojnë nga lehtësirat ushtarake dhe do të jenë në kushtet që aplikohen për personelin me rang ose gradë të njëjtë me personelin e vendit pritës, sipas rregullave në fuqi.

## Neni 5

Shtabi i SEEBRIG-ut do të gëzojë personalitet juridik, ai do të ketë të drejtën të lidhë kontrata, të blejë dhe të disponojë pasuri. Megjithatë vendi pritës dhe Shtabi i SEEBRIG-ut mund të bien dakord që vendi pritës të veprojë në emër dhe për llogari të Shtabit të SEEBRIG-ut në procese ligjore si ankues ose mbrojtës.

## Neni 6

Për të lehtësuar vendosjen në godinë, mirëmbajtjen e Shtabit të SEEBRIG-ut ai në përputhje me nenin 6 të Aneksit D të Marrëveshjes MPFSEE do të çlirohet nga shërbimet dhe taksat, që rrisin shpenzimet e tij në interes të objektivave të përcaktuara në Marrëveshjen e MPFSEE, si dhe përfitimet zyrtare dhe ekskluzive.

## Neni 7

Çdo truall, ndërtesa ose instalime të fiksuara për përdorim për Shtabin e SEEBRIG-ut të dhëna nga vendi i pritës pa pagesë për Shtabin dhe që nuk i nevojiten më tej Shtabit duhet t'i kthehet vendit pritës dhe çdo rritje ose humbje në vlerë të pasurisë së sigurisë nga vendi pritës që rezulton nga përdorimi i saj nga Shtabi mund të përcaktohet me konsensus nga Ministrat e Mbrojtjes së palëve (duke marrë në konsideratë çdo ligj që zbatohet në vendin pritës) dhe të shpërndahet ndërmjet ose t'u kreditohet, ose debitohet palëve të Marrëveshjes MPFSEE në përpjestim me kontributin e tyre në koston kapitale të Shtabit.

## Neni 8

Për të bërë të mundur kryerjen e veprimeve në buxhetin e përbashkët Shtabi i SEEBRIG-ut mund të përdorë monedhën në dallarë amerikanë ose monedhën e vendit pritës dhe të kryejë veprimet bankare me monedhën e vendit pritës.

#### Neni 9

Arkivat dhe dokumentet e tjera zyrtare të Shtabit të SEEBRIG-ut të mbajtura në mjediset e përdorura nga ky Shtab ose në zotërim nga çdo anëtar përkatës i autorizuar nga Shtabi duhet të jetë i paprekshëm, derisa Shtabi të ketë hequr dorë nga ky imunitet. Shtabi, me kërkesë të vendit pritës dhe në prezencë të një përfaqësuesi të atij shteti natyrën e çdo dokumenti për të konfirmuar që ato i përkasin imunitetit sipas këtij neni.

#### Neni 10

Të gjitha ndryshimet ndërmjet palëve ose ndërmjet çdo pale tjetër dhe Shtabit të SEEBRIG-ut që kanë të bëjnë me interpretimin ose zbatimin e këtij protokollit do të vendosen sipas nenit 13 të Marrëveshjes MPFSEE.

#### Neni 11

Ky Protokoll përbën një pjesë integrale të Marrëveshjes MPFSEE.

#### Neni 12

Ky Protokoll është subjekt ratifikimi. Dhjetë ditë pasi katër palë kanë njoftuar depozituesin rreth përfundimit të procedurave të tyre të brendshme, ky Protokoll do të hyjë në fuqi ndërmjet tyre. Për palët e tjera ai do të hyjë në fuqi 10 ditë pasi ata të njoftojnë depozituesin rreth përfundimit të procedurës së tyre të brendshme. Deri në hyrjen e tij në fuqi, ky Protokoll do të zbatohet provizorisht nga shteti nënshkruar i Marrëveshjes MPFSEE në territorin e të cilit është vendosur Shtabi. Lidhur me këtë, shteti nënshkruar në territorin e të cilit është vendosur Shtabi do të marrë masat e nevojshme që mund të kërkohen nga legjislacioni respektiv dhe do të njoftojë depozituesin për datën në të cilën do të fillojë zbatimi efektiv provizor i Protokollit aktual.

Nënshkruar në Athinë, më datë 21 Qershor 2000, në shtatë kopje origjinale në gjuhën angleze.

Në emër të Shteteve Palë të Marrëveshjes MPFSEE:

Zoti Ilir Boçka, Zëvendësministër i Mbrojtjes

Zoti Velizar Shalamov, Zëvendësministër i Mbrojtjes

Zoti Kadri Kadriu, Zëvendësministër i Mbrojtjes Kombëtare

Zoti Giovanni Riviera, Zëvendësministër i Mbrojtjes

Zoti Ion Mircea Plangu, Sekretar i Shtetit për Politikën e Mbrojtjes

Zoti Gjeneral Leitanant M.Sener Eruygur, Nënsekretar i Ministrisë së Mbrojtjes

### L I G J

**Nr.8817, datë 27.9.2001**

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT TREGTAR DHE EKONOMIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **K U V E N D I**

#### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

## Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit".

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3112, datë 3.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

### **MARRËVESHJE**

#### **NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT MBI BASHKËPUNIMIN TREGTAR DHE EKONOMIK**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit (më poshtë të quajtura "Palë"),

Duke njohur që bashkëpunimi tregtar dhe ekonomik janë faktorë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe mbi bazë të një bashkëpunimi afatgjatë të qëndrueshëm dhe të barabartë;

Duke dëshiruar të zhvillojnë marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike ndërmjet të dy vendeve mbi bazën e barazisë dhe përfitimit reciprok;

Duke u përpjekur të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e kontakteve ndërmjet njërive ekonomike të të dy vendeve dhe për nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik në fusha me interes të ndërsjellë;

Vendosën të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre tregtare në përputhje me principet bazë të marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT 1994) dhe Marrëveshjes Themelore për Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT);

Ranë dakort sa më poshtë:

## Neni 1

### **Objekti**

Objekt i kësaj Marrëveshjeje është të krijojë principet, rregullat dhe disiplinat për udhëheqjen e marrëdhënieve reciproke tregtare dhe ekonomike ndërmjet Palëve. Palët marrin përsipër, që nën kornizën e legjislacionit të tyre kombëtar dhe detyrimeve ndërkombëtare, të nxisin dhe harmonizojnë zhvillimin tregtar dypalëshe si dhe forma të ndryshme të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik.

## Neni 2

### **Trajtimi i kombit më të favorizuar**

1. Palët do t'i japin njëra-tjetrës trajtimin e kombit më të favorizuar në të gjitha fushat në lidhje me:

(a) tarifat doganore dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që zbatohet mbi importin dhe eksportin, duke përfshirë edhe rastet e përjashtimit nga këto taksa dhe pagesa;

(b) rregullat dhe formalitetet në lidhje me importin dhe eksportin duke përfshirë ato që lidhen me çdoganimin, tranzitimin, ruajtjen dhe transportin;

(c) taksat dhe shpenzime të tjera shtesë të çdo lloji tjetër që zbatohen direkt ose indirekt në përputhje me mallrat e importuara;

(d) shitjen, blerjen, transportin, shpërndarjen, ruajtjen dhe përdorimin e mallrave të importuara në tregun e brendshëm;

(e) pagesat lidhur me tregtimin e mallrave.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të jenë të zbatueshme për avantazhet që secila Palë ka akorduar ose mund të akordojë:

(a) vendeve fqinje me qëllim për lehtësimin e tregtisë kufitare;

(b) me qëllim për pjesëmarrje në një bashkim doganor, zonë të lirë tregtare apo organizimi ekonomik rajonal, siç është përcaktuar në Nenin XXIV të GATT 1994 ku secila Palë është anëtare ose mund të bëhet e tillë në të ardhmen.

(c) vendeve në zhvillim në përputhje me GATT/WTO.

### Neni 3

#### **Mosdiskriminimi**

Nuk do të aplikohen ndalesa apo kufizime sasiore mbi importet prej ose eksportet nga territori i Palës tjetër, përveçse në rastet kur importi, si produkt prej vendeve të treta ose eksporti si produkt i vendeve të treta, është i ndaluar apo i kufizuar. Pala që paraqet masa të tilla do të zbatohet ato në një mënyrë që dëmi për Palën tjetër të jetë minimal.

Secila Palë do të akordojë për produktet origjinale në ose eksportuar në territorin e Palës tjetër trajtim jo diskriminues në përputhje me kufizimet sasiore, lejimin e licensës dhe rregullat e procedurat për garancitë e huaja, në veçanti përpara i përket blerjes dhe dhënies së valutës së nevojshme për pagesën e mallrave të importuara dhe shërbimeve.

### Neni 4

#### **Tranzitimi**

1. Palët bien dakort që parimi për tranzitimin e lirë të mallrave është një kusht themelor për arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në këtë kuptim, secila Palë do të marrë masa për çrregullimet në tranzit ose ndërmjet territorit të tij për mallrat me origjinë në territoret doganore ose të destinuar për territore doganore të Palës tjetër në përputhje me nenin V të GATT 1994.

### Neni 5

#### **Trajtimi kombëtar**

Mallrave nga territori i njëjës Palë, importuar brenda territorit të Palës tjetër, do t'i akordohet trajtimi jo më pak i favorizuar sesa akordohet për mallrat me origjinë vendase, në përputhje me taksat e brendshme dhe pagesa të tjera shtesë dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe kërkesat që përdoren për shitjen e tyre të brendshme, ofertat për shitje, blerje, transportimi, shpërndarja ose përdorimi, në përputhje me nenin III të GATT 1994.

### Neni 6

#### **Liberalizimi**

Secila Palë do të akordojë për importin e produkteve të Palës tjetër liberalizimin në shkallën më të lartë të mundur. Procesi i liberalizimit do të ndikojë në zhvillimin e tregtisë ndërmjet Palëve, kushtet e tregut, ndryshimin në legjislacion dhe procedurat në lidhje me tregtinë në secilën Palë dhe do të çojë përpara zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 7

#### **Vendi i origjinës**

Vendi i origjinës do të përcaktohet në përputhje me ligjet dhe rregullat e secilës Palë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat të dyja Palët janë palë.

## Neni 8 Pagesat

1. Pagesat në lidhje me tregtinë e mallrave dhe shërbimeve midis vendeve do të bëhen në monedhë lirisht të konvertueshme, poqese nuk është pranuar ndryshe midis njësisve ekonomike individuale, në përputhje me ligjet dhe rregullat e këmbimit të monedhës të secilës Palë.

2. Njësitë e secilit vend të angazhuara në trasaksionet individuale nuk do të trajtohen më pak të favorizuara se njësitë e vendeve të treta në lidhje me mundësinë dhe transferimet e monedhës lirisht të konvertueshme.

## Neni 9 Masat antidumping dhe balancuese (countervailing)

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të paragjykojë ose do të ndikojë në asnjë formë, nga asnjë Palë, masat antidumping dhe balancuese (countervailing) në përputhje me nenin VI GATT të 1994, Marrëveshjen mbi Zbatimin e nenit VI të GATT dhe Marrëveshjen mbi Subvencionet dhe Masat Balancuese (countervailing).

## Neni 10 Kushte të tjera të biznesit

1. Mallrat do të tregtohen midis njësisve ekonomike të Palëve me çmimet e tregut dhe Palët nuk do të ndërhyjnë në çmimet e transaksioneve individuale. Në veçanti, agjencitë shtetërore dhe ndërmarrjet shtetërore do të bëjnë çdo blerje të importeve ose shitjeve të eksporteve vetëm në përputhje me konsideratat komerciale duke përfshirë çmimin, cilësinë dhe sasinë. Në rastet kur një njësi ekonomike e një Pale merr pjesë direkt ose indirekt në manaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një njësie ekonomike të Palës tjetër ose kur të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në manaxhimin, kontrollin ose kapitalin e njësisve ekonomike të të dyja Palëve, kushtet e marrëdhënieve tregtare midis tyre do të jenë si të njësisve të pavarura ekonomike.

2. Secila Palë, në përputhje me praktikatat e zakonshme të biznesit, do t'i akordojë ndërmarrjeve të Palës tjetër trajtim jodiskriminues dhe mundësi të mjaftueshme për të konkurruar në transaksione dhe tendera publike.

3. Asnjë Palë nuk do t'i kërkojë palëve të transaksioneve individuale të marrin përsipër shkëmbime barter ose transaksione counter-trade dhe as nuk do t'i inkurajojë ato të veprojnë kështu. Në rastin e shkëmbimit barter ose të counter-trade në prokurime publike, secila Palë do t'i ofrojë Palës tjetër trajtimin e kombit më të favorizuar dhe mundësi të barabarta konkurrimi.

## Neni 11 Përfashtime të veçanta nga taksat e import-eksportit

Palët do të lejojnë importin dhe eksportin e artikujve të mëposhtëm pa i ngarkuar me detyrime doganore, TVSH, akciza, taksa ose detyrime të tjera me efekt ekuivalent, si më poshtë:

a) Mostra dhe materiale të reklamave që nuk kanë vlera tregtare, në përputhje me nenet e Konventës Ndërkombëtare për Lehtësimin e Importit të Mostrave Tregtare dhe Materialeve të Reklamave, Gjenevë 1952;

b) artikuj të panairëve dhe ekspozitave, në përputhje me Konventën Doganore Lidhur me lehtësimet për Importimin e Mallrave për Reklamim ose Përdorim në Ekspozita, Panairë, Takime ose Veprimtari të Ngjashme. Bruksel, 1962.

c) kontenierë speciale dhe amlabazhe të rikthyeshme të përdorura në tregtinë ndërkombëtare, në përputhje me Konventën Doganore për importin e përkohshëm të kolive Bruksel, 1960 dhe konventës Doganore për Importin e Përkohshëm të Kolive Bruksel 1960 dhe Konventës Doganore për Kontenierët dhe Protokollin e Nënshkrimit, Gjenevë 1956.

## Neni 12

### **Bashkëpunimi ekonomik**

1. Palët do të nxisin shkëmbimin e informacionit me qëllim përmirësimin e tregtisë dypalëshe dhe bashkëpunimin ekonomik, në veçanti në lidhje me legjislacionin dhe procedurat e tregtisë, si dhe informacionin statistikor.

2. Palët bien dakord të nxisin bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik nëpërmjet masave që synojnë përmirësimin e tregtisë reciproke, duke përfshirë:

- organizimin dhe mbajtjen e panairëve, ekspozitave, konferencave, reklamave, konsulentëve dhe shërbimeve të tjera të biznesit;

- zhvillimin e kontakteve midis njësive të biznesit, shoqatave të manufakturave, dhomave të tregtisë dhe shoqatave të tjera të biznesit të të dyja Palëve;

- zhvillimin e përbashkët të bashkëpunimit ekonomik dhe industrial veçanërisht në fushat e aktiviteteve bujqësore dhe agro-industriale, si edhe në telekomunikacion, shëndetësi pajisje mjekësore, arsim dhe sektorët e sigurimeve.

## Neni 13

### **Veprimet emergjente**

1. Palët bien dakort të udhëhiqen nga neni XIX i GATT 1994 "Masat Emergjente për Importimin e Mallrave të Veçantë" dhe nga Marrëveshja mbi Sigurimet e EBT-së.

2. Palët duhet të konsultohen menjëherë me kërkesën e çdo Pale kur importet e produkteve me origjinë në territorin e Palës tjetër shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë dëme tek prodhuesit e brendshëm të produkteve të ngjashëm ose drejtpërsëdrejti konkurrues, me qëllimin e gjetjes së zgjidhjeve të menjëhershme për problemin e ngritur.

3. Në qoftë se si rezultat i konsultimeve të përmendura, Palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje, brenda një periudhe kohe të arsyeshme, në mënyrë që të parandalojnë ose të ndreqin dëmin, Pala importuese do të jetë e lirë që të marrë masat e nevojshme lidhur me importimin e produktit në fjalë dhe t'i zgjasë këto masa për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të parandaluar dëmin.

4. Në rrethana kritike, kur masë emergjente është e nevojshme për të parandaluar ose të ndreqë këtë dëmtim, Pala importuese mund të marrë masat e duhura pa një konsultim paraprak, me kusht që konsultimi të propozohet menjëherë pas marrjes së këtyre masave.

5. Në zgjedhjen e masave të përfshira në këtë nen, Palët duhet të përpiqen t'i japin prioritet atyre masave të cilat shkaktojnë me pak shqetësim në funksionimin e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 14

### **Përfaqësimi tregtar**

Palët duhet të lejojnë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre, hapjen në territorin e vendeve të tyre të përfaqësive tregtare të njësive legale të vendit tjetër.

## Neni 15

### **Përgjashtime të përgjithshme**

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk duhet të ndalojë Palët nga marrja e masave me qëllimin e mbrojtjes së interesave të sigurisë, moralit publik dhe rendit publik; mbrojtjen e jetës dhe shëndetit njerëzor, kafshëve dhe bimëve; mbrojtjen e pasurive kombëtare me vlera artistike, historike ose arkeologjike; ose të ndonjë mase tjetër referuar në nenin XX të GATT 1994. Ndalesa të tilla, megjithatë, nuk duhet të përbëjnë një mjet arbitrariteti ose diskriminimi të pajustificueshëm ose kufizimi të fshehtë të tregtisë midis Palëve.

2. Kjo Marrëveshje nuk kufizon të drejtën e çdo Pale për të marrë ndonjë veprim të justifikuar sipas referimeve në nenin 21 të GATT 1994.



Neni 16  
**Pasuria intelektuale**

1. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e pasurisë intelektuale për nxitjen e tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik, legjislacioni i secilës Palë duhet të sigurojë mbrojtje të plotë dhe efektive të të drejtave të pasurisë intelektuale, përfshirë në veçanti mbrojtje të plotë dhe efektive të të drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme me to, markës tregtare treguesve gjeografike, patentave pa diskriminim, ashtu si edhe në fushën e shpikjeve, projekteve industriale, topografisë së qarqeve të integruara dhe informacion të pakufizuar mbi know how.

2. Në veçanti Palët duhet të marrin të gjitha masat për t'u përshtatur me kushtet e Marrëveshjes së OBT-së mbi Aspektet e Lidhura me Tregtinë e të Drejtave të Pasurisë Intelektuale (Marrëveshja mbi TRIPS) e datës 15 prill 1994.

3. Për më tepër, palët duhet të bëjnë përpjekjet më të mira për t'u përfshirë në konventat ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pasurisë intelektuale.

Neni 17  
**Standardet**

1. Çdo Palë, me kërkesën e Palës tjetër, duhet të sigurojë informacion mbi standardet sipas porosisë.

2. Palët do të bashkëpunojnë në fushën e standardeve, përfshirë standardet cilësore, me qëllimin e reduktimit të barrierave teknike në tregti.

Neni 18  
**Komiteti i përbashkët**

1. Palët bien dakord të ngrejnjë një Komision të Përbashkët Shqiptaro-Izraelit mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Ekonomik (më pas i quajtur si "Komisioni i Përbashkët) me objektivin e lehtësimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Komiteti duhet të mblidhet me kërkesën e secilës Palë në mënyrë alternative në Tiranë dhe në Jerusalem. Koha e këtyre takimeve do të vendoset bashkërisht nga të dyja Palët.

2. Komiteti ndërmjet të tjerash:

(a) do të rishikojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të marrë në konsideratë masat që mund të merren me synimin e përmbushjes së klauzolave të saj;

(b) do të rishikojë zhvillimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet dy vendeve;

(c) do të shohë mundësitë e rritjes dhe ndryshimit të marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike, përfshirë bashkëpunimin industrial dhe investime mbi bazat e përfitimit reciprok, dhe të identifikojë fusha të reja për bashkëpunime të tilla;

(d) do të konsultojë në lidhje me problemet që mund të dalin në vazhden e zhvillimit ekonomik dhe marrëdhënieve tregtare ndërmjet të dy vendeve;

(e) do të formulojë dhe paraqesë tek autoritetet e Palëve amendamentet e kësaj Marrëveshjeje me qëllim që të merren në konsideratë zhvillimet e reja.

3. Komiteti do të paraqesë tek Palët raportet dhe rekomandimet në lidhje me çështjet e mësipërme, mbi bazën e një konsensusi reciprok.

Neni 19  
**Këshillimet**

Palët do të përpiqen që, nëpërmjet konsultimeve, të zgjidhin të gjitha çështjet që dalin nga interpretimi apo aplikimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që vjen pas ditës së shkëmbimit të notave zyrtare me të cilat Palët lajmërojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se procedurat e brendshme të tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar dhe do të mbesë në fuqi derisa njëra Palë të lajmërojë Palën tjetër, me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, për qëllimet e saj për t'i dhënë fund Marrëveshjes. Në raste të tilla, Marrëveshja do të përfundojë gjashtë muaj nga dita e lajmërimit të mësipërm nga Pala tjetër.

Me mbarimin e kësaj marrëveshjeje, klauzolat e saj do të vazhdojnë të aplikohen në të gjithë transaksionet tregtare të përfunduara sipas kësaj marrëveshjeje, por jo përpara mbarimit të Marrëveshjes.

Bërë në Jerusalem më 8 janar 2001 e cila korrespondon me 13 Tevet 5761, në tre kopje origjinale, në gjuhët shqip, hebraisht dhe anglisht, të tre tekstet janë njëllor autentikisht.

Në rast mosmarrëveshesh në interpretimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje, do të merret për bazë teksti në anglisht.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë Për Qeverinë e Izraelit

**L I G J**  
**Nr. 8818, datë 27.9.2001**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR KRIJIMIN E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË METROLOGJISË LIGJORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për krijimin e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore” .

Neni 2

Detyrimet financiare të Republikës së Shqipërisë, që rrjedhin nga ky anëtarësim, të përballohen nga Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe Kalibrimit.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3113, datë 3.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**KONVENTA**  
**PËR KRIJIMIN E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARETË METROLOGJISË LIGJORE**

Shtetet Palë në këtë Konventë, me dëshirën për të zgjidhur në nivel ndërkombëtar problemet teknike dhe administrative që kanë dalë nga përdorimi i instrumenteve matëse dhe të vetëdijshme për rëndësinë e koordinimit të përpjekjeve të tyre me qëllim arritjen e kësaj, kanë bërë marrëveshje të krijojnë një Organizatë Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore të përcaktuar si më poshtë:

**KREU I**  
**QËLLIMI I ORGANIZATËS**

Neni 1

Me anë të këtij dokumenti krijohet Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore. Qëllimi i kësaj Organizate është:

Të krijojë një qendër dokumentacioni dhe informacioni:

Nga njëra anë për departamentet e ndryshme kombëtare që kanë të bëjnë me inspektimin dhe kontrollin e instrumenteve matëse që janë në varësi apo i nënshtrohen rregulloreve ligjore,

Nga ana tjetër, për instrumentet matëse të lartpërmendura të para nga këndvështrimi i konceptimit, ndërtimit dhe përdorimit;

Të përkthejë dhe të redaktojë tekste me kërkesa ligjore për instrumentet matëse dhe t'i futi në fuqi ato në shtete të ndryshme, me të gjitha interpretimet që vijnë nga të drejtat kushtetuese dhe administrative të këtyre shteteve që janë të domosdoshme për t'i kuptuar sa më mirë këto kërkesa;

Të përcaktojë parimet e përgjithshme të Metrologjisë ligjore;

Të studiojë me synim unifikimin e metodave dhe rregulloreve, problemet e Metrologjisë, me karakter legjislativ dhe rregullator, zgjidhja e të cilave është me interes ndërkombëtar.

**KREU II**  
**NDËRTIMI I ORGANIZATËS**

Neni 2

Shtetet palë në këtë Konventë duhet të jenë anëtare të Organizatës.

Neni 3

Organizata duhet të përbëhet nga:

Një Konferencë Ndërkombëtare për Metrologjinë Ligjore

Një Komision Ndërkombëtar për Metrologjinë Ligjore

Një Byro Ndërkombëtare për Metrologjinë Ligjore

të cilat do të trajtohen si më poshtë:

**KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR METROLOGJINË LIGJORE**

Neni 4

Qëllimi i Konferencës duhet të jetë:

Të studiojë çështjet që kanë të bëjnë me qëllimet e organizatës dhe të marrë vendime lidhur me to.

Të sigurojë krijimin e organeve drejtuese, detyra e të cilave është të kryejë punën e organizatës;

Të studiojë dhe miratojë raporte që bëhen në përfundim të punës së tyre nga organe të

ndryshme Metrologjike ligjore të krijuara në përputhje me këtë konventë;

Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin dhe administrimin e një shteti të posaçëm duhet të lihen jashtë nga kompetenca e Konventës, përveçse me kërkesë të shprehur nga ai shtet.

#### Neni 5

Shtetet Palë në këtë Konventë duhet të bëjnë pjesë në Konferencë si anëtare, si pasojë duhet të përfaqësohen siç parashtrohet në Nenin 7 dhe duhet t'i nënshtrohen detyrimeve që përcaktohen në këtë Konventë.

Përveç anëtarëve, si anëtarë me korrespondencë, mund të marrin pjesë si më poshtë:

Shtetet apo territoret të cilat s'duan ende të jenë palë në këtë Konventë;

Sindikatat Ndërkombëtare që zhvillojnë një aktivitet që lidhet me atë të Organizatës.

Anëtarët me korrespondencë mund të mos përfaqësohen në Konferencë po mund të emërojnë vëzhgues thjesht me cilësinë e këshillimit. Ato mund të mos paguajnë kuotizacionet si shtete palë, por duhet të mbulojnë vetë shpenzimet e sigurimit të këtyre shërbimeve që mund të kërkojnë, si dhe shpenzimet për abonimet në botimet e Organizatës.

#### Neni 6

Shtetet palë marrin përsipër t'i sigurojnë Konferencës të gjithë dokumentacionin që kanë, i cili, sipas mendimit të tyre, do t'i japë mundësi Organizatës të përmbushë detyrat që i janë besuar.

#### Neni 7

Shtetet palë duhet të dërgojnë një delegacion maksimumi tre përfaqësues zyrtarë në takimet e konferencës. Brenda mundësive, njëri prej tyre duhet të jetë zyrtar që punon në vendin e tij, në Departamentin e Peshave dhe të Masave apo departamente të tjera që kanë lidhje me Metrologjinë Ligjore.

Vetëm njëri ka të drejtën e votës.

Këta delegatë nuk kanë nevojë të kenë "kompetenca të plota", përveç se kur kjo gjë kërkohet nga Komisioni në raste të jashtëzakonshme dhe për çështje të përcaktuara qartë.

Çdo shtet duhet të mbulojë vetë shpenzimet që dalin nga përfaqësimi në Konferencë.

Anëtarët e Komisionit të paemëruar nga qeveritë e tyre kanë të drejtën të marrin pjesë në takime si këshilltarë.

#### Neni 8

Konferenca vendos për rekomandimet që bëhen për veprimet e përbashkëta nga shtete anëtarë në fushat e përcaktuara në nenin 1.

Vendimet e konferencës mund të hyjnë në fuqi vetëm nëse numri i shteteve anëtare të pranishme është të paktën sa dy të tretat e numrit total të shteteve anëtare dhe nëse ato kanë marrë minimumi katër të pestat e votave të hedhura. Numri i votave të hedhura duhet të jetë të paktën katër të pestat e shteteve anëtare të pranishme.

Abstenimet dhe votat e paplotësuara apo të pavlefshme nuk konsiderohen si vota të hedhura. Vendimet duhet t'u komunikohen menjëherë shteteve anëtare për informim, shqyrtim dhe rekomandim. Këta të fundit duhet të kenë detyrimin moral t'i zbatojnë këto vendime sa më shumë të jetë e mundur. Megjithatë, për të gjitha votat që lidhen me organizimin, administrimin dhe rregullat e procedurës të Konferencës, të Komisionit dhe të Byrosë, dhe të të gjitha çështjeve analoge, është e mjaftueshme vetëm shumica dërrmuese që këto vendime në fjalë të hyjnë në fuqi menjëherë, me një minimum numër anëtarësh të pranishëm dhe votat e hedhura kanë të njëjtën fuqi. Vota e shtetit anëtar delegati i së cilës është në kryesi duhet të jetë vendimtare në rastet kur ka ndarje të barabartë votash.

#### Neni 9

Konferenca zgjedh nga anëtarët e saj, për kohëzgjatjen e çdo seance të saj një President dhe 2 zëvendëspresidentë, të cilëve u bashkëngjitet si sekretar Drejtori i Byrosë.

#### Neni 10

Konferenca duhet të mblidhet të paktën një herë në 6 vjet me kërkesën e Presidentit të Komisionit, ose nëse ka ndonjë gjë që e pengon këtë, me kërkesë të Drejtorit të Byrosë, nëse ky i fundit merr kështu një kërkesë nga të paktën gjysma e anëtarëve të Komisionit.

Konferenca duhet të përcaktojë në fund të punës së saj, vendin dhe datën e takimit tjetër, ose në të kundërtën duhet t'ia delegojë këtë përgjegjësi Komisionit.

#### Neni 11

Gjuha zyrtare e Organizatës është frëngjishtja. Megjithatë, Konferenca duhet të sigurojë përdorimin e një ose të disa gjuhëve të tjera për punën dhe debatet e saj.

### KOMISIONI NDËRKOMBËTAR I METROLOGJISË LIGJORE

#### Neni 12

Detyrat e parashikuara në nenin 1 duhet të merren përsipër dhe të përmbushen nga një Komision Ndërkombëtar i Metrologjisë Ndërkombëtare, organi operativ i Konferencës.

#### Neni 13

Komisioni duhet të përbëhet nga një përfaqësues i çdo shteti anëtar i Organizatës. Këta përfaqësues caktohen nga Qeveria e shtetit të tyre. Ato duhet të jenë nëpunës që punojnë në departamentin që ka të bëjë me instrumentet matëse apo që kanë funksione aktive zyrtare në fushën e Metrologjisë ligjore. Ato nuk do të jenë më anëtarë të Komisionit menjëherë sapo ato nuk përmbushin kushtet e mësipërme, dhe atëherë i takon qeverive të caktojnë pasuesit e tyre. Ato duhet t'i japin ndihmesë Komisionit me përvojën, këshillat dhe punën e tyre, po nuk duhet të kompromentojnë Qeverinë apo Administratën e tyre. Anëtarët e Komisionit duhet të marrin pjesë me ligj si këshilltarë në takimet e Konferencës. Ato mund të jenë një nga delegatët e qeverisë së tyre në këtë Konferencë. Presidenti mund të ftojë në takimet e Komisionit, si këshilltar çdo person pjesëmarrja e të cilit atij i duket me vlerë.

#### Neni 14

Individët që kanë marrë pjesë në shkencën apo industrinë e Metrologjisë apo anëtarë të mëparshëm të Komisionit, mund të marrin, me vendim të Komisionit, titullin Anëtar Nderi. Ata mund të marrin pjesë si këshilltarë në takime.

#### Neni 15

Komisioni duhet të zgjedhë ndërmjet anëtarëve të tij një President, dhe një zëvendëspresident të parë dhe një të dytë i cili duhet të zgjidhet për një periudhë gjashtë vjeçare dhe ka të drejtën të zgjidhet përsëri në zgjedhjet e tjera. Megjithatë, nëse mandati i tyre mbaron në intervalet ndërmjet dy seancave, ai duhet automatikisht të zgjatet deri në seancën e dytë.

Drejtori i Byrosë është atashuar pranë tyre si Sekretar. Komisioni ia delegon disa nga detyrat e tij Presidentit.

Presidenti mund t'i kryejë detyrat që i janë deleguar atij nga Komisioni dhe duhet të zëvendësojë Komisionin kur vendimet janë urgjente. Ai duhet t'ia bëjë të ditur këto vendime anëtarëve të Komisionit dhe duhet t'ia raportojë ato pa u vonuar.

Kur dalin çështje të interesit të përbashkët për Komisionin që janë të lidhura me Organizatat, Presidenti duhet të përfaqësojë Komisionin para këtyre Organizatave.

Në rast të mungesës, pengesave, mbarimit të mandatit, dorëheqjes apo vdekjes së presidentit, detyrat e tij i kalojnë përkohësisht zëvendëspresidentit të parë.

#### Neni 16

Komisioni duhet të takohet të paktën një herë në dy vjet me kërkesën e Presidentit ose nëse ka ndonjë gjë që e pengon këtë, me ftesë të Drejtorit të Byrosë, nëse ky i fundit mer një kërkesë për këtë gjë nga të paktën gjysma e anëtarëve të Komisionit.

Me përjashtim të rasteve të veçanta, seancat normale duhet të zhvillohen në atë shtet ku Byroja ka selinë e saj. Takimet për qëllime informuese mund të zhvillohen megjithatë në territorin e secilit prej shteteve anëtare.

#### Neni 17

Anëtarët e Komisionit që s'kanë mundësi të marrin pjesë në një takim, mund t'ia delegojnë votën e tyre njërit prej kolegëve të tyre, i cili pastaj do të jetë përfaqësuesi i tyre. Në këtë rast, një anëtar i vetëm s'mund të ketë më shumë se dy vota përveç votës së vet.

Vendimet janë të vlefshme vetëm nëse numri i atyre që janë të pranishëm dhe përfaqësohen të paktën nga tre të katërtat e numrit të personave të emëruar si anëtarë të komisionit dhe nëse ato mbështeten nga minimumi katër të pestat e votave të hedhura. Numri i votave të hedhura duhet të jetë të paktën katër të pestat e numrit të atyre të pranishëm dhe të përfaqësuar në seancë.

Abstenimet, votat e paplotësuara dhe të pavlefshme s'duhet të konsiderohen si vota të hedhura.

Ndërmjet seancave dhe në disa raste të veçanta, Komisioni duhet të konsultohet nëpërmjet korrespondencës.

Rezolutat e miratuara në këtë mënyrë duhet të jenë të vlefshme vetëm nëse anëtarëve të Komisionit iu është bërë ftesë që të japin mendimet e tyre dhe nëse rezolutat që janë miratuar njëzëri nga të të gjithë ata që kanë votuar, me kusht që numri i votave të hedhura të jetë të paktën dy të tretat e numrit të anëtarëve të emëruar.

Abstenimet, votat e paplotësuara dhe të pavlefshme s'duhet të konsiderohen si vota të hedhura. Mosdhënia e përgjigjes brenda afatit kohor të specifikuar nga Presidenti duhet të konsiderohet si abstenim.

#### Neni 18

Komisioni duhet t'ia besojë studimet e veçanta, kërkimet eksperimentale dhe punën laboratorike departamenteve kompetente të shteteve anëtare, pasi të kenë marrë së pari miratimin e tyre zyrtar. Nëse detyra të tilla kërkojnë shpenzime, marrëveshja duhet të specifikojë se ç'pjesë e këtyre shpenzimeve duhet të mbulohet nga Organizata.

Drejtori i Byrosë duhet ta koordinojë dhe ta grumbullojë këtë punë.

Komisioni duhet t'ia besojë disa detyra përgjithnjë apo përkohësisht grupeve të punës apo ekspertëve teknikë apo ligjorë, që veprojnë në përputhje me metodat të cilat ai ka përcaktuar. Nëse këto detyra përfshijnë pagesë apo ndonjë shpërblim apo dëmshpërblim, shumat duhet të vendosen nga Komisioni.

Drejtori i Byrosë duhet të marrë përsipër detyrat e sekretariatit për këto grupe pune apo grupe ekspertësh.

## Neni 19

### **Byroja Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore**

Funksionimi i Konferencës dhe i Komisionit sigurohet nga Byroja Ndërkombëtare e Metrologjisë Ndërkombëtare, nën drejtimin dhe kontrollin e Komisionit. Byroja duhet të jetë përgjegjëse për përgatitjen e Konferencës dhe takimeve të Komisionit për të vendosur marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të ndryshëm të këtyre organeve, dhe për mbarëvajtjen e këtyre marrëdhënieve me shtetet anëtare apo me anëtarët përkatës dhe departamenteve që kanë lidhje me to.

Ajo duhet të jetë, gjithashtu, përgjegjëse për kryerjen e studimeve dhe të punës së përcaktuar sipas nenit 1 si dhe për të mbajtur shënime zyrtare dhe të botojë një buletin, që duhet t'iu dërgohet falas shteteve antëare.

Ai duhet të krijojë qendrën e dokumentacionit dhe informacionit të përcaktuar me ligj, sipas nenit 1.

Komisioni dhe Byroja duhet të jenë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Konferencës.

Byroja s' duhet të bëjë asnjë kërkim eksperimental apo punë laboratorike. Ajo mundet, megjithatë, të vërë në përdorim sallat e demonstrimit të pajisura në mënyrë të përshtatshme për studimin e formës së ndërtimit dhe funksionimit të disa aparaturave.

## Neni 20

Byroja duhet ta ketë selinë e saj administrative në Francë.

## Neni 21

Personeli i Byrosë duhet të përbëhet nga një drejtor dhe asistentë të emëruar nga Komisioni përveç të punësuarve apo agjentëve, të marrë në punë nga drejtori ose përgjithnjë ose përkohësisht.

Personeli i Byrosë dhe, nëse lind nevoja, ekspertët e përmendur në nenin 18, duhet t'iu lidhet rrogë. Ato duhet të marrin një rrogë mujore ose vjetore apo zhdëmtime sasia e të cilave përcaktohet nga Komisioni.

Statusi i drejtorit, i asistentëve dhe i të punësuarve apo agjentëve, përcaktohet nga Komisioni, sidomos në lidhje me kushtet e marrjes në punë, punës, disiplinës dhe pensionit.

Emërimi, shkarkimi apo heqja nga puna e agjentëve e të punësuarve të Byrosë duhet të bëhet me urdhër të drejtorit, me përjashtim të rasteve kur asistentët emërohen nga Komisioni, të cilët mund t'iu nënshtrohen këtyre masave të marra me vendim të Komisionit.

## Neni 22

Drejtori duhet të jetë përgjegjës për punën e Byrosë nën kontrollin dhe drejtimin e Komisionit, të cilit ai i jep llogari dhe të cilit ai duhet t'iu paraqesë në çdo seancë të zakonshme, një raport për drejtimin e biznesit.

Drejtori duhet të mbledhë të ardhurat, të përgatisë buxhetin, duhet të përgjigjet për të gjitha derdhjet, që kanë të bëjnë me personelin dhe pajisjet, dhe të administrojë fondet.

Drejtori duhet, me ligj, të jetë sekretar i Konferencës dhe i Komisionit.

## Neni 23

Qeveritë e shteteve anëtare deklarojnë që Byroja duhet të njihet si shërbim publik, që duhet të ketë status ligjor, dhe se në përgjithësi duhet të përfitojë nga privilegjet dhe lehtësirat që u jepen zakonisht organeve ndërqeveritare sipas ligjeve në fuqi në secilin prej shteteve anëtare.

### KREU III KLAUZOLA FINANCIARE

#### Neni 24

Për një periudhë financiare, e barabartë me intervalin ndërmjet seancave të saj, Konferenca duhet të vendosë:

Shumën e përgjithshme të kredive të nevojshme për të mbuluar shpenzimet e veprimtarisë së Organizatës.

Shumën vjetore që duhet të lihet rezervë për të mbuluar shpenzimet themelore në rast urgjence dhe të sigurojë zbatimin e buxhetit në rastet kur të ardhurat duket se janë të pamjaftueshme.

Kreditë duhet të llogariten në franga floriri. Barazia e frangës të floririt dhe frangës franceze duhet të kuotohet nga Banka e Francës.

Gjatë periudhës financiare, Komisioni mund t'u kërkojë shteteve anëtare, nëse ai e sheh të nevojshme një rritje të kredive me qëllim që të përmbushen detyrimet e Organizatës, apo për shkak të një ndryshimi në kushtet ekonomike.

Kur mbaron periudha financiare, nëse Konferenca nuk është mbledhur ose nëse nuk ka mundur të zhvillojë një debat të vlefshëm, periudha financiare duhet të zgjatet deri në seancën tjetër të vlefshëm. Kreditë fillestare duhet të rriten në përputhje me kohëzgjatjen e kësaj zgjatjeje.

Gjatë periudhës financiare, brenda kufijve të garantuara të kredisë, Komisioni do përcaktojë sasinë e shpenzimeve operuese që i përkasin periudhave të buxhetit, shpenzimeve të barabarta në kohëzgjatje me intervalin ndërmjet dy seancave. Ai duhet të mbikqyrë investimin e fondeve të vëna në dispozicion.

Kur mbaron viti buxhetor, nëse Komisioni nuk është mbledhur apo s'ka mundur të zhvillojë një debat të vlefshëm, Presidenti dhe Drejtori i Byrosë duhet të vendosin mbi rinovimin deri në seancën tjetër të vlefshme të tërë buxhetit apo të një pjesë të buxhetit për vitin financiar që sapo ka mbaruar.

#### Neni 25

Drejtori i Byrosë duhet të autorizohet të marrë përsipër dhe të bëjë pagesa me iniciativën e vet në lidhje me shpenzimet operuese të Organizatës.

Po ai nuk mund:

- të paguajë shpenzime të jashtëzakonshme;

- të tërheqë para nga rezerva e vendosur me qëllim sigurimin e zbatimit e buxhetit në rast të faturave të pamjaftueshme, pa marrë së pari miratimin e Presidentit të Komisionit.

Tepricat e buxhetit duhet të mbeten në dispozicion për përdorim gjatë gjithë periudhës financiare.

Administrimi i buxhetit nga Drejtori duhet t'i paraqitet Komisionit që do ta verifikojë atë në secilën prej seancave të tij.

Me mbarimin e periudhës financiare, Komisioni duhet t'i paraqesë Konferencës bilancin e administrimit.

Konferenca duhet të vendosë se ç'duhet të bëhet me ndonjë tepricë; sasia e kësaj teprice ose mund të lejojë një ulje përkatëse në kuotat e shteteve anëtare ose përndryshe duhet t'u shtohet fondeve rezervë.

#### Neni 26

Shpenzimet e Organizatës duhet të mbulojnë:

nga kontributet vjetore të shteteve anëtare.

Totali i kontributeve për një periudhë të caktuar financiare duhet të përcaktohet sipas shumave e të kredive të dhëna nga Konferenca, duke marrë parasysh një vlerësim të faturave që burojnë nga paragrafët 2 deri 5 më poshtë.



Për të përcaktuar pjesën përkatëse të shteteve anëtare, këta të fundit ndahen në katër kategori sipas popullsisë së përgjithshme të shtetit dhe territoreve të përfaqësuara.

Klasa 1: me popullsi prej 10 milionë banorësh apo më pak;

Klasa 2: me popullsi ndërmjet 10 milionë, përjashtuar dhe 40 milionë përfshirë;

Klasa 3: me popullsi ndërmjet 40 milionë përjashtuar dhe 100 milionë përfshirë;

Klasa 4: me popullsi prej mbi 100 milionë.

Shifrat e popullsisë janë rrumbullakosur deri në milionin e fundit.

Kur përdorimi i instrumenteve matës në çdo shtet duket qartë se është poshtë mesatares, shteti duhet të bëjë kërkesë për t'u futur në një klasë më të ulët se ajo që i është përcaktuar nga popullsia e vet.

Në varësi të klasës, kontributet janë në proporcion me 1,2,4 dhe 8.

Pjesa e një shteti anëtar duhet të ndahet në mënyrë të barabartë gjatë gjithë viteve të një periudhe financiare me qëllim që të përcaktohet kontributi i tij vjetor.

Me qëllim që të vendoset një kufi sigurie që nga fillimi parë me qëllim që të kompensohen luhatjet në fatura, shtetet anëtare bien dakord për të bërë parapagime për kuotat e tyre vjetore të ardhshme. Shuma e saktë dhe kohëzgjatja e këtyre parapagimeve duhet të përcaktohet nga Konferenca.

Nëse, me mbarimin e periudhës financiare, Konferenca s'është takuar apo nuk ka mundur të zhvillojë një debat të vlefshëm, kontributet vjetore duhet të rinovohen me të njëjtat tarifa derisa të mblidhet një seancë tjetër.

Nga arkëtimet nga shitja e botimeve dhe arkëtimet nga sigurimi i shërbimeve ndaj anëtarëve të korespondencës; nga të ardhura nga fondet e investimit; nga kontributet për periudhën aktuale financiale dhe kuotat e pranimit të shteteve anëtare - nga kontributet prapavepruese dhe kuotat e hyrjes së shteteve anëtare të ripranuara- nga kontributet e vonuara të shteteve anëtare, që rifillojnë pagesat pas ndërprerjes së tyre; nga subvencionet, abonimet, dhurimet apo nga trashëgimet dhe fatura të ndryshme.

Për të financuar punë të veçanta, disa shteteve anëtare duhet t'u caktohen subvencione shtesë. Ato s'duhet të përfshihen në buxhetin e përgjithshëm, por duhet të vendosen në llogari të veçanta.

Kontributet vjetore duhet të llogariten me franga floriri. Ato duhet të paguhen me franga franceze apo me çdo monedhë të konvertueshme. Barazia ndërmjet frangës floriri dhe frangës franceze duhet të kuotohet nga Banka e Francës, tarifa e aplikueshme është ajo e ditës së parapagimit.

Kontributet duhet t'i paguhen në fillim të vitit Drejtorit të Byrosë.

## Neni 27

Komisioni duhet të përgatitë një kod financiar mbi klauzolat e përgjithshme të neneve 24 deri 26 lart.

## Neni 28

Një shtet që bëhet anëtar i Organizatës, gjatë njërës nga periudhat e treguara në nenin 26 i nënshtrohet deri në mbarimin e kësaj periudhe dhe do t'i nënshtrohet që nga periudha e pranimit, të njëjtave detyrime si anëtarët ekzsitues.

Një shtet anëtar i ri bëhet bashkëpronar i pasurisë së Organizatës dhe, duke patur parasysh këtë fakt, duhet të paguajë një taksë pranimi të përcaktuar nga Konferenca.

Kuotizacioni vjetor duhet të llogaritet sikur ai është futur me 1 janar të vitit që pason atë depozitimit të dokumenteve të pranimit apo të nënshkrimit. Pagesa për vitin aktual do të jetë një e dymbëdhjeta e kuotizacioneve shumëzuar me muajt që kanë mbetur nga viti.

## Neni 29

Të gjitha shtetet anëtare të cilat nuk kanë paguar kuotizacionet e tyre për tre vite radhazi do quhen nga ana zyrtare sikur kanë dhënë dorëheqjen dhe duhet të hiqen nga lista e shteteve anëtare.

Megjithatë, situata e disa shteteve anëtare që mund të jenë duke kaluar një periudhë të vështirë financiare dhe për momentin mund të mos jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre duhet të verifikohet nga Konferenca e cila në disa raste mund t'u sigurojë atyre shtyrje të afatit apo falje të borxhit.

Pamjaftueshmëria e faturave që rrjedh nga eliminimi i një shteti anëtar do kompensohet nga tërheqja nga fondet rezervë, që janë krijuar siç shpjegohet në nenin 24.

Shtetet anëtare që japin dorëheqjen me dëshirën e vet dhe shtetet anëtare zyrtarisht të konsideruara sikur kanë dhënë dorëheqjen i humbin të gjitha të drejtat e bashkëpronësisë mbi pronat e Organizatës.

## Neni 30

Një shtet anëtar që me dëshirë ka dhënë dorëheqjen mund të ripranohet me kërkesën e tij. Atëherë ai do konsiderohet si një shtet anëtar i ri, po taksa e pranimit duhet të jetë e pagueshme vetëm nëse dorëheqja është bërë më shumë se pesë vjet para.

Një shtet anëtar që zyrtarisht quhet se ka dhënë dorëheqjen mund të ripranohet me kërkesë të tij, me kusht që ai të paguajë kuotizacionet e papaguara që i kishte për t'i paguar në kohën kur u hoq nga lista. Këto kontribute të prapambetura duhet të llogariten në bazë të kuotizacioneve për vitet para ripranimit të tij. Paskëtaj ai konsiderohet një shtet anëtar i ri por pagesa e pranimit duhet të llogaritet duke marrë parasysh kuotizacionet e mëparshme, në raporte të vendosura nga Konferenca.

## Neni 31

Në rast të shpërbërjes së Organizatës, pasuritë duhet të shpërndahen në mes të gjithë shteteve anëtare, në përpjestim me totalin e kuotave të mëparshme sipas marrëveshjes që është bërë ndërmjet këtyre shteteve anëtare, të cilat kanë paguar kuotat e tyre deri në datën e shpërbërjes dhe sipas të drejtave të kontraktuara apo të kërkuara nga personeli që është në shërbim aktiv apo ka dalë në pension.

## KREU IV KLAUZOLA TË PËRGJITHSHME

## Neni 32

Kjo Konventë mbetet e hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1955, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Franceze.

Ajo duhet të miratohet.

Dokumentet e miratimit duhet të depozitohen në Qeverinë e Republikës Franceze, e cila do njoftojë secilin nga shtetet nënshkruese për datën e depozitimit të tyre.

## Neni 33

Shtetet të cilat nuk e kanë nënshkruar Konventën mund të hyjnë deri me mbarimin e afatit kohor të përcaktuar me ligj në nenin 32.

Dokumentet e hyrjes duhet të depozitohen në Qeverinë e Republikës franceze, e cila do njoftojë të gjitha Qeveritë nënshkruese dhe që marrin pjesë për datën e depozitimit të tyre.

## Neni 34

Kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas depozitimit të dokumentit të gjashtëmbëdhjetë të miratimit apo të pranimit\*.

---

\* Konventa hyri në fuqi më 28 maj, 1958

Ajo duhet të hyjë në fuqi për çdo shtet i cili do miratojë apo do marrë pjesë në të pas kësaj date, tridhjetë ditë pas depozitimit të dokumenteve të miratimit apo të pranimit.

Qeveria e Republikës Franceze duhet të njoftojë secilën nga Palët Kontraktuese për datën e hyrjes në fuqi të Konventës.

#### Neni 35

Çdo shtet mundet, që në kohën e nënshkrimit, të miratimit apo në çdo kohë tjetër, të deklarojë me njoftim drejtuar Qeverisë së Republikës Franceze, që kjo Konventë është e zbatueshme për të gjithë apo një pjesë të territoreve që ajo përfaqëson në nivele ndërkombëtare.

Kjo Konventë duhet të vihet në zbatim në territoret e përcaktuara në këtë njoftim nga dita e tridhjetë, pas datës në të cilën Qeveria e Republikës Franceze e ka marrë këtë njoftim.

Qeveria e Republikës Franceze duhet t'ua përcjellë këtë njoftim të gjithë anëtarëve të Qeverive.

#### Neni 36

Kjo Konventë përfundon pas një periudhe dymbëdhjetëvjeçare që llogaritet nga data kur ajo hyn në fuqi.

Paskëtaj, ajo duhet të mbetet në fuqi për periudha të njëpasnjëshme prej gjashtë vjetësh si ndërmjet atyre palëve kontraktuese që nuk e kanë prishur atë të paktën gjashtë muaj para mbarimit të periudhës paraardhëse.

Njoftimi për prishje duhet t'i dërgohet me shkrim Qeverisë së Republikës Franceze, e cila do të këshillohet pastaj me palët kontraktuese.

#### Neni 37

Organizata mund të shpërbëhet me vendim të Konferencës, nëse delegatëve iu jepen "Kompetenca të Plota" për këtë qëllim në atë kohë.

#### Neni 38

Nëse numri i palëve në këtë Konventë pakësohet në më pak se gjashtëmbëdhjetë, Konferenca duhet të konsultohet me shtetet anëtare për të vendosur nëse ka baza që Konferenca të shfuqizohet.

#### Neni 39

Konferenca mund t'u rekomandojë amendamente palëve kontraktuese të kësaj Konvente.

Çdo palë kontraktuese që pranon një amendament duhet të njoftojë Qeverinë Franceze për pranimin e tij me shkrim. Dhe ky i fundit duhet të njoftojë palët e tjera kontraktuese për marrjen e këtij njoftimi të pranimit.

Një amendament duhet të hyjë në fuqi tre muaj pas marrjes së njoftimit të pranimit nga të gjitha palët kontraktuese nga Qeveria e Republikës Franceze. Kur një amendament pranohet nga të gjitha palët kontraktuese, të Republikës Franceze, Qeveria e Republikës Franceze duhet të këshillohet me palët kontraktuese, si dhe me qeveritë nënshkruese për t'i informuar ato për datën e hyrjes në fuqi.

Pasi një amendament ka hyrë në fuqi, asnjë qeveri s'mund ta miratojë këtë Konventë apo të marrë pjesë në të, pa pranuar gjithashtu këtë amendament.

#### Neni 40

Kjo Konventë duhet të hartohet në gjuhën frënge me një kopje origjinale, e cila duhet të depozitohet në arkivat e Qeverisë Franceze, e cila duhet të dërgojë kopje të vërtetuara të gjitha qeverive nënshkruese dhe pjesëmarrëse në të.

Hartuar në Paris më 12 tetor 1955

(përmirësuar në Janar 1968 nga amendamenti i nenit 13)

**D E K R E T**  
**Nr.3116, datë 9.10.2001**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME NË ZONËN ZGJEDHORE  
NR.98, DELVINË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” të Kushtetutës, si dhe të neneve 4 dhe 11 pika 3 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, bazuar në njoftimin e Kryetarit të Kuvendit,

**D E K R E T O J:**

Neni 1

Zgjedhjet e pjeshme për deputet në zonën zgjedhore nr.98, Delvinë të zhvillohen ditën e diel, datë 18 nëntor 2001, ndërsa raundi i dytë të zhvillohet ditën e diel, datë 2 dhjetor 2001.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Rexhep Meidani**

**D E K R E T**  
**Nr.3117, datë 10.10.2001**

**PËR DHËNIE DHE LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19,20 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

**D E K R E T O J:**

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Hysen Elmaz Sejdini
2. Velentina Mina Guda
3. Armenita Hysen Sejdini
4. Enxhi Hysen Sejdini
5. Megi Hysen Sejdini
6. Mezan Shefqet Psatha
7. Zenepe Zenel Psatha
8. Arben Mezan Psatha
9. Shkëlqim Mezan Psatha
10. Vasil Vançi Pano
11. Marije Janaq Pano
12. Nesti Vasil Pano

13. Alketa Vasil Ambo (Pano)
14. Ismet Riza Tuzi
15. Jusuf Ahmet Dermani
16. Nezir Rexh Nezaq
17. Sabrije Refat Nezaq
18. Fatmir Nezir Nezaq
19. Shkelzen Nezir Nezaq
20. Shpresa Nezir Nezaq
21. Ikballe Ferhat Feratoviç
22. Fatmir Zufer Feratoviç
23. Valbona Zufer Mehmeti (Feratoviç)
24. Fatbardha Zufer Feratoviç
25. Dhurata Zufer Feratoviç
26. Zufer Medos Feratoviç

Neni 2

Lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesën e saj:

1. Marjeta Barjam Guduni (Stüber)

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Rexhep Meidani**

**V E N D I M**  
**Nr.7, datë 15.10.2001**

**SHQIPËRIA – PJSËTARE E ALEANCËS SË GJERË KUNDËR TERRORIZMIT  
NDËRKOMBËTAR**

Bazuar në debatin parlamentar, të datës 15 tetor 2001, të kërkuar me konsensusin e plotë të Byrosë Parlamentare të Kuvendit;

- duke parë përmasat që ka marrë rreziku i terrorizmit në botë, si dhe duke vlerësuar domosdoshmërinë e luftës kundër terrorizmit në plan global;
- duke kuptuar thellë rëndësinë e kësaj lufte për mbrojtjen e vlerave të njerëzimit përballë antivlerave dhe përballë të keqes universale;
- duke përshëndetur aleancën globale me SHBA-në në krye dhe duke mbështetur plotësisht aksionet e tyre politike dhe ushtarake në luftën kundër terrorizmit botëror;
- duke vlerësuar se institucionet e shtetit shqiptar kanë rolin dhe rëndësinë e tyre në luftën kundër terrorizmit në shkallë rajonale dhe në shkallë globale;
- në mbështetje të neneve 88 dhe 158 të Rregullores,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

1. Të ndjekë me përparësi dhe në vazhdimësi në tërë kompleksitetin e vet politik, juridik, ushtarak dhe ekonomik luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, duke rritur vazhdimisht ndihmesën e Shqipërisë në këtë luftë.

2. Të ndërmarrë, të përkrahë dhe të mbështesë të gjitha nismat e nevojshme, brenda dhe jashtë vendit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe të gjitha trafikeve e tranziteve që lënë shteg për akte terroriste.

3. Qeveria dhe institucionet e angazhuara në luftën kundër terrorizmit, brenda një periudhe sa më të shkurtër, të nënshkruajnë të gjitha marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare në shkallë rajonale e globale për luftën kundër terrorizmit.

4. Kuvendi i Shqipërisë, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2002, të ratifikojë të gjitha marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare në luftë kundër terrorizmit, të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare.

5. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ i Shtetit, në bashkëpunim me komisionet parlamentare, të rishikojnë legjislacionin që lidhet me luftën kundër terrorizmit dhe të bëhen përmirësimet e nevojshme, me synim forcimin e kontrollit dhe të masave të tjera të nevojshme.

6. Kryeministri i Shqipërisë, në hapje të sesionit të parë të vitit 2002, të informojë Kuvendin për punën që është bërë në zbatim të rezolutave të mëparshme të Kuvendit dhe të angazhimeve të Qeverisë në luftën kundër terrorizmit. Informime periodike përpara Kuvendit do të bëjnë edhe anëtarët e Qeverisë, sipas fushave që mbulojnë.

7. Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm, për të identifikuar dhe parandaluar depozitimin, qarkullimin ose transferimin e parave të shoqatave ose të individëve që financojnë veprime terroriste. Për këto masa të informohet Kuvendi.

8. Prokurori i Përgjithshëm, çdo gjashtë muaj të informojë Kuvendin për gjendjen e kriminalitetit dhe luftën kundër trafikeve dhe tranzitit të paligjshëm, si dhe mbrojtjen e objekteve të cilat mund të jenë pikësynime të goditjeve të terrorizmit. Informimi i parë të bëhet në fillim të vitit 2002.

9. Kryetari i Shërbimit Informativ të Shtetit të informojë çdo 6 muaj Nënkomisionin e SHISH-it në Komisionin e Përhershëm të Rendit dhe SHISH-it të Kuvendit për masat e marra për parandalimin dhe zbulimin e veprimeve të elementëve terroristë. Informimi i parë të bëhet brenda muajit dhjetor 2001.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.566, datë 13.10.2001**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2001, MIRATUAR PËR GJYKATËN  
KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit në Republikën e Shqipërisë“ dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1.Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, në zërin “Investime”, t’i shtohet një fond prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Gjykata Kushtetuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 117, datë 28.8.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,    | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci,      | Anëtar i ““                    |
| Gjergj Sauli    | Anëtar i ““                    |
| Kristofor Peçi, | Anëtar i ““                    |
| Kujtim Puto,    | Anëtar i ““                    |
| Petrit Plloçi,  | Anëtar i ““                    |
| Tefta Zaka,     | Anëtare e ““                   |
| Sokol Sadushi,  | Anëtar i ““                    |

me sekretare Drita Panda, në datën 28.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.123 Akti që i përket:

**KËRKUESE:**PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Engjëll Bejtaj dhe Mirash Martini.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. KOALICIONI “BASHKIMI PËR FITORE”, përfaqësuar nga Ferdinand Pone dhe Vladimir Mulaj, me prokurë.

**O B J E K T I:**

Shfuqizimi i pjesshëm i vendimeve nr. 227 dhe nr. 228, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si të papajtueshëm me nenin 64/2 të Kushtetutës.

Kërkuesi, për shfuqizimin pjesërisht si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të sipërcituara, ka parashtuar këto shkaqe kryesore:

- Nuk është zbatuar neni 64/2 i Kushtetutës, sepse numri i deputetëve të shpërndarë partive apo koalicioneve nga lista shumemërore nuk është bërë në raport të afërt me votat e vlefshme të fituara prej tyre. Nga kjo shpërndarje e padrejtë Partia Socialdemokrate ka marrë një deputet më pak.

- Nuk duhej zbatuar neni 66 i Kodit Zgjedhor, por duhej zbatuar drejtpërdrejt neni 64 i Kushtetutës, sepse ky është i vetmi nen që përcakton sistemin zgjedhor në Shqipëri. Zbatimi i drejtpërdrejtë i Kushtetutës jep si rezultat që Partia Socialdemokrate të përfitojë gjithsej 5 deputet në Kuvend.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr.227 dhe nr.228, datë 21.8.2001, ka shpallur mandatet e fituara nga partitë për listat shumemërore, nga ku rezultoi se Partia Socialdemokrate mbi bazën e 48.253 votave të fituara në raundin e parë të zgjedhjeve, të cilat llogariten në 3,645% të votave të vlefshme, ka përfituar 4 vende në Kuvend. Këto vendime janë nxjerrë, duke u bazuar në kriteret dhe rregullat që ka parashikuar neni 66 i Kodit Zgjedhor.

Kërkuesi pretendon se vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili nuk i ka caktuar 5 vende në Kuvend, nuk janë në përputhje me nenin 64 të Kushtetutës dhe për rrjedhojë dhënia e një deputeti më shumë koalicionit “Bashkimi për Fitore”, nga lista shumemërore, ka cenuar drejtpërdrejt numrin e vendeve në parlament që Partia Socialdemokrate duhej të përfitonte.

Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme të ritheksojë edhe njëherë qëndrimin tashmë të konsoliduar në vendimin nr.49, datë 2.6.2001 se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 64 të saj ka pranuar se sistemi i zgjedhjeve nuk është proporcional i pastër, por një kombinim i elementeve të sistemit mazhoritar me atë proporcional. Ky konkluzion i Gjykatës Kushtetuese që ka dalë mbi bazën e interpretimit kushtetutes që ajo ka kryer, qartëson dhe nuk krijon mundësinë e konfundimeve të ndryshme mbi llojin e sistemit zgjedhor të pranuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Pretendimi i kërkuesit për aplikimin e një formule të ndryshme nga ajo që parashikon neni 66 i Kodit Zgjedhor, jo vetëm që do të cenonte nga njëra anë interesat e partive apo koalicioneve të tjera të cilat përfitojnë nga listat shumemërore, por njëkohësisht do të binte ndesh dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të sipërcituar, e cila duke mos u shfuqizuar formulën si antikushtetuese, e ka bërë atë detyrues të zbatueshme për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për përcaktimin e 40 mandateve plotësuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të shkelte Kushtetutën dhe ligjin nëse do të aplikonte formula të ndryshme nga ajo që ka parashikuar Kodi Zgjedhor. Mbi këtë bazë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke zbatuar kërkesat e nenit 66 të Kodit Zgjedhor, ka caktuar vendet për të gjitha partitë e koalicionet, nga ku ka rezultuar se kërkuesit i përkisnin vetëm 4 deputet.

Edhe pretendimi tjetër i kërkuesit për zbatimin drejtpërdrejtë të nenit 64 të Kushtetutës, duke iu referuar nenit 4 të saj pasi kjo do të sillte sipas tij përfitimin e 5 vendeve në Kuvend, nuk është i drejtë. Në Kushtetutën tonë është pranuar zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave të saj, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Vetë Kushtetuta në nenin 68 të saj ka parashikuar se rregullat për caktimin e kandidatëve për deputetë, për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, si dhe kushtet e vlefshmërisë së zgjedhjeve rregullohen nga ligji për zgjedhjet. Pra ekziston një Kod Zgjedhor, i cili nuk mund të zbatohet. Përderisa Kodi Zgjedhor, nëpërmjet nenit 66 të tij, ka parashikuar një mënyrë të ndarjes së mandateve shtesë, e cila kërkon detyruesisht një formulë ligjore dhe përsa kohë kjo dispozitë nuk është konsideruar si antikushtetuese, atëherë zbatimi i drejtpërdrejtë i nenit 64 të Kushtetutës nuk mund të sjellë ndonjë ndarje të ndryshme të mandateve shtesë.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.49, datë 2.6.2001 ku kërkues ka qenë dhe Partia Socialdemokrate, i ka bërë një interpretim nenit 64 të Kushtetutës, duke konkluduar se nocioni raport sa më i afërt nuk është i njëjtë me nocionin e raportit saktësisht të barabartë që përpiket të zbatohet kërkuesi. Sistemi i zgjedhjeve që ka pranuar Kushtetuta nuk mund të japë një raport saktësisht të barabartë midis numrit të deputetëve të çdo partie dhe votave të vlefshme të fituara prej tyre.

Nga sa parashtruam më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për të shfuqizuar vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk janë të drejta dhe për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës, në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, njëzëri,

#### V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.



**V E N D I M**  
**Nr.124, datë 27.9.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci       | Anëtar i            " "        |
| Gjergj Sauli    | Anëtar i            " "        |
| Alfred Karamuço | Anëtar i            " "        |
| Kristofor Peçi  | Anëtar i            " "        |
| Petrit Plloçi   | Anëtar i            " "        |
| Tefta Zaka      | Anëtar i            " "        |
| Sokol Sadushi   | Anëtar i            " "        |
| Kujtim Puto     | Anëtar i            " "        |

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 20.6.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.59 Akti që i përket:

**KËRKUES:** PAJTIM ARIFAJ, përfaqësuar nga avokat Halil Ahmetaj, me prokurë.

**SUBJEKTI i INTERESUAR:** PROKURORI I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

**O B J E K T I:**

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.33, datë 7.6.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr.126 datë 26.9.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.153, datë 8.2.2001 të Kolegjit Penal Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të mësipërm:

1. Policia gjyqësore ka bërë paraqitjen për njohje të sendeve të vjedhura pa praninë e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij dhe pa urdhër delegimi të prokurorit, në kundërshtim të hapur me nenet 171-173 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Paraqitja për njohjen e personit (të pandehurit) është bërë në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, gjë që sjell pavlefshmërinë absolute të akteve procedurale.

3. Gjykata e Apelit Shkodër ka gjykuar çështjen pa praninë e të pandehurit në kundërshtim me rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

4. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë nuk vërtetohet me provat që përmban dosja penale dhe praktika e Gjykatës së Lartë që nuk analizon provat është praktikë antikushtetuese.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr.33, datë 7.6.2000, ka deklaruar fajtor kërkuesin Pajtim Arifaj për veprën penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 140-25 të Kodit Penal e ka dënuar me 10 (dhjetë) vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Sipas kompetencave të tyre, gjykatat kanë marrë provat dhe i kanë çmuar sipas bindjes së

formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi ndërsa pretendimet e kërkuarit për mangësi procedurale në paraqitjen për njohje të sendeve të vjedhura apo për shkelje të këtyre rregullave në paraqitjen për njohjen e të pandehurit nuk kanë sjellë në vetvete shkeljen e të drejtave themelore të të gjykuarit dhe si rrjedhojë nuk kanë të bëjnë me procesin jo të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42/1 e 131/f të Kushtetutës. Vlerësimi i provave, metodika e taktika e njohjes, si dhe vlefshmëria apo pavlefshmëria e akteve çmohen nga gjykatat e sistemit gjyqësor si në gjykim, ashtu edhe në rishikimin e çështjeve sipas Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata Kushtetuese nuk gjen elementët e procesit jo të rregullt në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës edhe përsa i përket pretendimit se gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë pa praninë e të pandehurit.

Para gjykimit të çështjes në atë gjykatë, kërkuari ka bërë kërkesë për të marrë pjesë në gjykim dhe meqenëse nuk u bë e mundur sjellja e tij, gjykimi i çështjes u shty dy herë. Por, në seancën e datës 26.9.2000 avokati i të pandehurit deklaroi para gjykatës se i pandehuri është i sëmurë dhe se ka kërkuar që gjykimi i çështjes të zhvillohet në mungesë të tij. Pavarësisht se kërkesa e të pandehurit nuk ishte hartuar sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale përderisa deklarimi është bërë në seancë gjyqësore nga vetë avokati i të pandehurit, gjykata është e detyruar ta marrë këtë si të mirëqenë. Po të vepronte ndryshe, ajo do të vinte në dyshim marrëdhëniet e avokatit me të pandehurit që ai mbron dhe do të cenonte të drejtën e mbrojtjes. Sipas nenit 50/1 të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, ndërsa sipas paragrafit të tretë të po atij neni i pandehuri mund të zhvlerësojë me deklaram të hapur veprimin e kryer nga mbrojtësi, por para se të jetë marrë vendimi nga gjykata lidhur me këtë veprim.

Ndryshe nga sa pretendon kërkuari, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ishte i detyruar t'i përmbahej kompetencave të përcaktuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe të mos i hynte vlerësimit të provave sepse sipas nenit 178/1 të Kushtetutës ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 e vijuesa të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës

- Ky vendim është përfundimisht, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 15.10.2001  
Doli nga shtypi më 18.10.2001

Tirazhi: 4210 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë